

Relacion mbi ecurinë e projekteve të financuara nga programet evropiane

Bashkia Finiq është përfituese e programit Interreg IPA CBC Greece- Albania 2014-2020 me katër projekte **MileSTONES II**- “Encouraging tourism development through the preservation and promotion of the cross border cultural and natural resources”, **RyTHM**- ‘Fostering Creativity and Connecting Cultural Assets through Monuments’, **MILESTONES III** “Creative cultural cooperation as a tool for stronger tourism capacity and development” dhe **SOLIS**: “Cross - border cooperation for energy efficiency using solar energy”. Dy projektet e para Rhythm dhe MILESTONES II janë përfunduar me sukses, ndërsa dy projektet e tjera MILESTONES III dhe SOLIS janë në proces implementimi.

Projekti RyTHM- ‘Nxitja e Kreativitetit dhe Lidhja e Aseteve Kulturore Përmes Monumenteve.’

Ky projekt ishte një bashkëpunim me Drejtorinë e Antikiteteve të Korfuzit dhe Teatrit Lokal dhe Rajonal të Korfuzit. Drejtoria e Korfuzit është Partneri Lider (LP), Teatri Lokal i Korfuzit Partner i dytë (P2), ndërsa bashkia Finiq Partner i tretë (P3). Bashkia përfitoi një shumë granti prej **234.900,00 Euro** të shtrirë në periudhën zbatuese prej 24 muajsh duke filluar nga data 01.07.2017. Në përputhje me *Marrëveshjen e Financimit për Programin e Bashkëpunimit Ndërkufitar Interreg Greqi-Shqipëri 2014-2020*, miratuar me Ligjin Nr. 137/2016, date 22.12.2016, siç parashikohej nga ky ligj shuma totale e fondeve të BE-së për institucionin në kuadër të projektit me titull “*RyTHM*” do të sigurohej në masën 85% nga granti i BE kurse pjesa e mbetur prej 15% duhet të përballohej nga institucioni.

Objektivi kryesor i projektit të propozuar RyTHM është valorizimi i dy monumenteve të rëndësishme në zonën ndërkufitare Greqi-Shqipëri me qëllim rritjen e njohurive në lidhje me vlerën e trashëgimisë lokale, nxitjen e kreativitetit, forcimin e identitetit rajonal dhe rritjes e atraktivitetit të zonës për vizitorët në mënyrë që të mbështesin rritjen ekonomike. Të dy shtetet kanë një trashëgimi kulturore të pasur, materiale dhe jo materiale. Sidoqoftë të dy vendet duhet të merren me sfidat aktuale në lidhje me promovimin dhe rritjen e pasurive të tyre kulturore dhe valorizimin e tyre të duhur për të mirën e komuniteteve lokale, por edhe për publikun e gjerë, sidomos për të rinjtë. Duke trajtuar çështjet e përbashkëta të menaxhimit efikas kulturor, RyTHM hulumton efektet e mbivendosjes së ruajtjes së trashëgimisë në turizëm dhe në zhvillimin e sektorit krijues. Projekti gjithashtu propozon mënyra për të fuqizuar turizmin kulturor dhe për të nxitur bashkëpunimin ndërkufitar midis institucioneve kulturore dhe organizatave.

Për të arritur objektivin e tij, projekti RyTHM ka për qëllim krijimin e:

- Hapësirave kulturore të përmirësuara, të modifikuara, rehabilituara dhe të përforcuara në Korfuz dhe Finiq, në mënyrë që ato të mund të presin vizitorët për nismat kulturore dhe ngjarjet e kulturës bashkëkohore.
- Banka i ideve kulturore do të rritet nga themelimi i një Grupi Mbështetës Lokal. Kjo do të veprojë si një qendër për prodhimin dhe organizimin e iniciativave kulturore ndërkufitare me një efekt afatgjatë dhe do të ofrojë mundësi trajnimi për artistët e rinj.

- Iniciativa të përbashkëta kulturore siç janë shfaqjet dhe ngjarjet e arteve pamore që do të sjellin në qendër të vëmendjes hapësirat e reja të shtuara në të dy vendet dhe të rrisin profilin kulturor dhe turistik të zonës së projektit.

Aktivitetet e lartpërmendura do të përfitojnë komunitetet lokale duke rritur numrin e vizitorëve dhe duke ofruar mundësi sipërmarrëse. Ata gjithashtu do të përfitojnë vizitorët që kërkojnë një përvojë unike kulturore në zonën ndërkufitare. Bizneset turistike do të kenë mundësinë të zgjerojnë shërbimet e tyre ekzistuese dhe të propozojnë destinacione të reja kulturore. Të rinjve do t'u jepet mundësi të reja për të shfaqur talentin e tyre dhe për të shprehur kreativitetin e tyre. Autoritetet lokale do të fitojnë kapacitet me pjesëmarrjen e tyre në menaxhimin e përbashkët të burimeve kulturore në zonën ndërkufitare. Risi e projektit qëndron në futjen e bashkëpunimeve "të papritura" midis praktikuesve të ruajtjes kulturore dhe agjentëve të inovacionit kulturor, duke zhvilluar së bashku zgjidhje efikase për përmirësimin e përvojave kulturore. Qasja ndërkufitare është më e përshtatshme si një mjet për t'u marrë me sfidat e përbashkëta në lidhje me burimet kulturore dhe shkëmbimin e njohurive të specializuara dhe praktikave më të mira për të përfituar aktorët kulturorë dhe shoqërinë civile. Vlera e shtuar për zonën e programit është futja e veprimeve të integruara dhe koherente që çojnë në valorizimin e zgjuar të pasurive kulturore të dy zonave.

Konkretisht, bashkia në kuadër të këtij programi ka përfunduar qendrën kulturore të Livadhjasë. Gjithashtu, është implementuar një paketë me aktivitete, materiale promovuese, aplikacione, një ambient i jashtëm me lojëra kreative. Akte të cilat synojnë objektivat kryesore të këtij projekti.





Projekti MileSTONES ‘Inkurajimi i zhvillimit të turizmit përmes ruajtjes dhe promovimit të burimeve kulturore dhe natyrore ndërkufitare.’

Ky projekt është një bashkëpunim me bashkinë e Dodonës, Drejtorinë e Antikiteteve të Janinës dhe Drejtorinë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore të Vlorës. Bashkia e Dodonës është Partneri Lider, bashkia e Finiqit partneri i dytë, Drejtoria e Antikiteteve të Janinës është partneri i tretë dhe Drejtoria e Vlorës partneri i katërt. Bashkia jonë përfitoi një shumë granti prej **132.433,00 Euro** të shtrirë në periudhën zbatuese prej 24 muajsh duke filluar nga data 09.05.2018. Në përputhje me *Marrëveshjen e Financimit për Programin e Bashkëpunimit Ndërkufitar Interreg Greqi-Shqipëri 2014-2020*, miratuar me Ligjin Nr. 137/2016, date 22.12.2016, parashikohej që shuma totale e fondeve të BE-së për institucionin në kuadër të projektit me titull “MileSTONES II” do të sigurohej në masën 85% nga granti i BE kurse pjesa e mbetur prej 15% duhet të përballohej nga institucioni.

Projekti Milestones II, si vazhdim i projektit të implementuar më parë Milestones I, kishte si objektivi që përmes ndërhyrjeve inovative që u ndërmorrën, të nxisë zhvillimin ekonomik lokal nëpërmjet turizmit dhe kulturës.

Projekti është planifikuar në përputhje të plotë me Objektivin Specifik të Thirrjes 2.1 "Ruajtja e burimeve kulturore dhe natyrore si parakusht për zhvillimin e turizmit në zonën ndërkufitare". Objektivi i përgjithshëm i projektit është mbrojtja, ruajtja dhe zhvillimi i trashëgimisë kulturore të zonës së CB duke u fokusuar mbi Finiqin dhe Dodonin, duke promovuar turizmin e qëndrueshëm dhe duke nxitur rritjen ekonomike.

Sipas OECD ekziston një lidhje e fortë midis turizmit dhe kulturës, e cila me veprimet e duhura mund të ndikojë në atraktivitetin dhe konkurrencën e një destinacioni. Nevoja për të mbrojtur dhe ruajtur kulturën në zonën e CB , nuk është vetëm mjete por më tepër një kusht

për të krijuar dallueshmëri lokale përballë globalizimit. (a) Përforcimi I mëtejshëm I trashëgimisë kulturore ndërkufitare, (b) ruajtja e madhësisë dhe reputacionit të saj në kohë me aktivitete promovuese, (c) pasurimit të monumenteve kulturore nëpërmjet rehabilitimit të dy Kishave Bizantine, (d) zmadhimin e zinxhirit kulturor të atraksionit dhe (e) lidhjen e kulturës me turizmin tematik, janë disa nga objektivat kryesore të suksesit të projektit.

(f) Një tjetër faktor kyç është se turizmi rinor po rritet me shpejtësi çdo vit, "Rinia kërkon përvoja kulturore" (WYSE Travel Confederation), duke mbajtur së paku 20% të tregut të përgjithshëm. Nëpërmjet zhvillimit të aplikacioneve digjitale, 360 VR tours, Realitetit të Zgjeruar, etj, dhe zgjerimit të qasjes multimediale në kulturën CB, qëllimi është që të qasim me vendosmëri këtë grup-target.

Kontributi në Objektivin Specifik të Prioriteteve të Programit është përmbushja e të lartpërmendurave që do të rrisin ndjeshëm numrin e pritshëm dhe kohëzgjatjen e vizitave në monumentet e lidhur me rrugën kulturore MileSTONES , duke rritur ndjeshëm qëndrimin turistik brenda natës në zonën e CB, duke ndihmuar rritjen e qëndrueshme ekonomike në zonën e gjerë.

Më konkretisht, në këtë projekt u përfshinë, mes të tjerash, restaurimi i Kishës së Shën Kollit Mesopotam për përforcimin e strukturave të saj dhe kthimit të vizitueshmërisë për vizitorët, restaurimi i Shtëpisë së Kulturës në Dhrovjan duke e bërë funksionale nëpërmjet përdorimit të sistemeve inovative të teknologjisë, studimi i vizibilitetit për Muzeun e ardhshëm të Finiqit, etj.





Projektet në të cilat jemi shpallur fitues në programin Interreg IPA CBC Greece- Albania 2014-2020 në thirrjen e katërt të tij.

Projekti Milestones III- "Ruajtja e burimeve kulturore dhe natyrore si parakusht për zhvillimin e turizmit të zonës ndërkufitare"

Ky projekt është vazhdimi i projektit Milestones I dhe II ku Bashkia e Dodonës si partnere kryesore bashkëpunon sërisht me bashkinë tonë (Partner i dytë), bashkinë e Prevezës (Partner i Katërt) që vjen si partner i ri në bashkëpunim si dhe Drejtorinë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore të Vlorës (Partner i tretë).

Projekti është planifikuar në përputhje të plotë me Objektivën Specifike të Thirrjes 2.1. "Ruajtja e burimeve kulturore dhe natyrore si parakusht për zhvillimin e turizmit të zonës ndërkufitare". Qëllimi i përgjithshëm i projektit është të përmirësojë aftësinë për të menaxhuar dhe rigjallëruar trashëgiminë kulturore dhe të mbështesë rritjen në turizëm.

Në këtë projekt jemi përfitues të një shume prej **316.459,00 Euro** të shtrirë në periudhën zbatuese prej 24 muajsh. Zbatimi i projektit pritet të fillojë në fillim të vitit 2021.

Më konkretisht, në këtë projekt pritet të ndërmerren akte si: ndërtimi i një muzeu experiential dhe etnografik në Livadhja, një paketë promovuese që do të përfshijë dhe teknologji inovative, si dhe financimin e një festivali kulturor.

Deri më tani janë kryer të gjitha përgatitjet e nevojshme të materialeve promovuese për turizmin e zonës si harta e monumenteve të bashkisë, përpunimi i një ditari me festat kryesore të zonës sonë si dhe është gati promovimi i traditave të zonës. Dhe po përfundon përgatitja e festivalit folklorik FOINIKEA që do të organizohet në muajin nëntor ose dhjetor.

Jemi mbrapa me procedurat e muzeut eksperimental dhe etnografik në Livadhja për arsye teknike. Por, që së shpejti do të arrijë të realizohet.

Projekti SOLIS

Ky projekt është pjesëmarrja jonë e parë në Aksin Prioritar 1 të këtij programi i cili fokusohet në 'Promovimin e mjedisit, transportin e qëndrueshëm dhe infrastrukturën publike', në tematikën prioritare 1B 'Mbrojtja e mjedisit dhe promovimi i përshtatjes dhe zbutjes së ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe administrimi i rreziqeve, ndër të tjera: veprime të përbashkëta për mbrojtjen e mjedisit; promovimi i përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore, efikasitetit të burimeve, burimeve të energjisë së rinovueshme dhe zhvendosjes drejt një ekonomie të ulët dhe të qëndrueshme të karbonit të ulët, duke promovuar investime për të adresuar rreziqe specifike, duke siguruar rezistencën ndaj katastrofës dhe zhvillimin e sistemeve të menaxhimit të katastrofave dhe gatishmërinë për emergjente'. Me objekt specifik 1.3 Rritjen e efikasitetit të energjisë dhe përdorimi i BRE.

Partnerët janë: bashkia e Prevezës (partner Lider), bashkia e Finiqit (partner i dytë), Universiteti i Janinës (Partner i tretë).

Bashkia jonë është përfituese e një shume prej **828.952,23 Euro** të shtrirë në periudhën zbatuese prej 24 muajsh. Zbatimi i projektit pritet të fillojë në fillim të vitit 2021. Ndër të tjera në këtë projekt është edhe rikonstruksioni i objektit shkolla në fshatin Aliko.

Për arsye të specifikave të veçanta të konstruksionit të elementëve fotovoltaikë në çatinë e kësaj godine jemi akoma mbrapa në implementimin e këtij projekti. Por shumë shpejt mendojmë se edhe ky projekt do të realizohet brenda afatit.

Përgatiti:

Ilir Papa

Përgjegjës i Njësisë së Integritit European dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj